

VENDIM
Nr.11, datë 10.1.2007

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT TË SIPËRFAQES SË TRUALLIT NË
KTHESËN E KAMZËS, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja e truallit në kthesën e Kamzës, Tiranë, prej 85 000 m² në parcelën nr.68, në zonën kadastrale 2679, në fshatin Mëzes, e regjistruar në volum 4, faqe 161, me pronar shtet, të kalojë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për administrimin e këtij trualli dhe për mbarëvajtjen e marrëveshjes me shoqërinë malajziane “PSC”, për projektin e strehimit.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha